



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:026166

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06024077

CAP.nr.639/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi Prishtina sh.a. (KRU Prishtina), me seli në P....., Rruga “Hazir Shala”, Nr.4, kundër debitorit F.M rruga” Skënderbeu” nga P....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SH.B, avokat nga P....., lidhur me çështjen përmbare për borxh, në vlerë prej 2,276.88 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.7/2023 datë 15.02.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, me datë 06.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi Prishtina sh.a. (KRU Prishtina), me seli në Prishtinë, Rruga “Hazir Shala”, Nr.4, ndërsa aktvendimi i PPP.nr.7/2023 datë 15.02.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, në pikën -I-, të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika -II-, e dispozitivit të aktvendimit PPP.nr.7/2023 datë 15.02.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.7/2023 datë 15.02.2023, ka vendosur që të:
“I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar, prapësimi i debitorit të përmbaremit: F.M nga P..... rr.” Skënderbeu” dhe shfuqizohet Urdhri mbi caktimin e Përmbaremit P.nr.48/2021 të dt:19.01.2021, të Përmbareuesve Private Mr. Sc. V.B dhe Mr.Sc. I.G nga P....., si organ përmbareues nga shuma prej 2.276.88 euro. Për periudhën para datës 01.01.2013 deri me dt.31.12.2017 kishte arritur shuma prej 2.164.55. euro. Prandaj Shuma e parashkruar për këtë periudhe deri me dt.31.12.2017 është shuma prej 2.164.55 euro e kërkesës si objekt i përmbaremit. II. Refuzohet si i pa bazuar, prapësimi i debitorit të përmbaremit: F.M rr. “ Skënderbeu” nga Podujeva, sa i përket kërkesës objekt i përmbaremit në shumën prej 112.33 € për periudhën prej 01.01.2018

deri me dt. 14.01.2021 dhe për këtë shumë Urdhëri mbi Caktimin e Përmbarrimit P.nr.48/2021 të dt:19.01.2021, mbetet në fuqi”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur kreditori për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave procedurale konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën ta ndryshoj dhe të vazhdoje procedurën e përmbarrimit apo ta anuloj atë dhe lënda te kthehet ne ri-procedurë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit LP19741 për periudhën kohore 01.01.2013 deri me datë 14.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim, ndaj debitorit për shumën e detyrimit në lartësi prej 2,276 €, për shërbimet e konsumimit të ujit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të këtij vendimi, me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit.

Përmbarruesi Privat V.B në P...., duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrit Përmbarrimor me shenjë P.nr.48/21 datë 19.01.2021, me të cilën e ka lejuar përmbarrimin sipas ekstraktit të lartcekur, duke e pranuar si dokument të besueshëm, i cili i plotëson kushtet për ta lejuar përmbarrimin.

Kundër Urdhrit përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 01.02.2021, duke propozuar që të Aprovohet prapësimi i debitorit dhe anulohet Urdhri për caktimin e përmbarrimit i Përmbarruesit Privat P.nr.48/21 datë 19.01.2021, për arsye se nuk i plotëson kushtet ligjore për lejimin e përmbarrimit, pasi që borxhi i kërkuar është parashkruar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar, ka vendos që ta aprovoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e ndryshuar pjesërisht Urdhrit Përmbarrimor, P.nr.48/21 datë 19.01.2021, dhe e ka refuzuar një pjesë të kërkesës propozimit për përmbarrim, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit siç është vendosur në dispozitivin e aktvendimit të goditur më ankesë, Andaj gjykata e shkallë së parë, vlerëson është

llogaritur se shpenzimin e ujit për biznes dhe jo për amvisëri, prandaj prapësimi i debitorit të përmbarimit duhet të aprovohet pjesërisht si i bazuar dhe ka vendosur që pas konstatimit në këtë pjesë borxhi i kërkuar të realizohet me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditori i përmbarimit propozimin për përmbarim e ka paraqitur me dt:19.01.2021, ndërsa sipas nenit 378 par. 1 lidhur me nenin 374 i LMD-së 1978 dhe sipas nenit 355 lidhur me nenin 360.1 të LMD-së që ka hyrë në fuqi me dt. 20.12.2012, Ligji nr.04/L- 077 dhe është zbatuar nga data 01.01.2013 me ç’ rast është rregulluar se: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake” parashkruhen pas kalimit të një viti, ndërsa, sipas paragrafit 2 të njëjtit neni është rregulluar se: “afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”. Kurse kërkesat reciproke për kontratat komerciale neni 355 par.1 i LMD-se përcakton se: ”kërkesat reciproke komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata , parashkruhen për 3 (tri) vite”. Njëjtë është dhe me nenin 374 të LMD-se 1978. Andaj sipas dispozitave të cituara të LMD-së, rrjedhimisht kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë pra para dt. 01.01.2013 kur kishte arritur borxhi në shumën prej 1.750.00 euro dhe deri me datë e deri me dt. 31.12.2017 në shumën prej 2.164.55. €. Pra kemi parashkrim të borxhit në shumën prej 2.164.55 euro kurse pjesa tjetër prej 112.33 euro, për periudhën prej 01.01.2018 deri me datë 14.01.2021 mbetet për tu paguar nga debitori sepse kemi të bëjmë me biznes e jo amvisëri dhe nevojitet afati 3 vjeçar i parashkrimit konform nenit 355 par.1 të LMD-së. Mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, debitori i përmbarimit nuk ka të drejtë në pretendimet e tij për periudhën prej 01.01.2018 deri me dt. 14.01.2021 në shumën prej 112.33 euro, të cilën shumë është i obliguar t’ia paguaj kreditorit të përmbarimit dhe kreditori ka të drejtë në këtë shumë si në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti në këtë pjesë nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë në këtë pikë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) të LPK-së, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar n është

mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerësoi mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbartimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor se gjykata ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit nuk qëndrojnë për faktin se gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LKP-se, për arsye se Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e refuzuar një pjesë të prapësimit të debitorit, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka bërë aplikimin e të drejtës materiale, për arsye se në bazë të nenit 360 paragrafi 1 pika 1.1 përcaktohet se: “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: *“1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*”.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, vërejti se kreditori nuk ka parashtruar pretendime në raport me pikën -II- të aktvendimit të atakuar, prandaj kjo pikë e dispozitivit të aktvendimit të atakuar ka mbetur e pa shqyrtuar, ashtu si është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.639/2023 me datë 06.08.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci